



ETIKA DHE PAJTUESHIMËRIA

SPEAKUP! POLITIKA E SINJALIZIMIT

SpeakUp! Politika e sinjalizimit

	Version 3, Tetor 2024
Versioni i parë	Prill 2012
Numri i faqeve	13
Emri i politikës	SpeakUp! Politika e sinjalizimit
	Shpjegon se si të raportoni shkeljet dhe përshkruan hapat kryesorë që ndiqen në trajtimin e raportimeve
Dok. të lidhura	Parimet e Sjelljes dhe Veprimi Udhëzues për hetuesin e sinjalizimeve SpeakUp! Paketa e komunikimit Njoftim informues mbi të dhënat personale
	Të gjithë punonjësit e kompanive të Grupit ose sipërmarrjeve të përbashkëta të kontrolluara ekskluzivisht ose bashkërisht nga Grupi, si dhe palët e treta të Grupit.
Përshtatja lokale	Kjo politikë sinjalizimi mund të përshtatet në nivel lokal për të marrë parasysh rrethanat specifike lokale, gjithsesi pa cenuar mbrojtjen e sinjalizuesve dhe personave të përmendur në sinjalizim.
	Anglisht dhe frëngjisht Versionet lokale në gjuhët e tjera gjenden këtu: Rajonet
Niveli i konfidentalitetit	Dokument publik, i disponueshëm në qendrën e burimeve në faqen www.saint-gobain.com dhe në l'intranet
	Departament i Etikës dhe Pajtueshmërisë
Shqyrtoi	
	Drejtori i CSR, DPO i Grupit

Claire Pedini, Zëvendës Presidente, Burimet Njerëzore

TABELA E LËNDËS

I. RAPORTIMI I NJË INCIDENTI	05
1. Çfarë lloj shkeljesh mund të raportohen?	05
2. Si raportohet një incident?	07
3. Çfarë informacioni jepet në raportim?	08
II. TRAJTIMI I SINJALIZIMEVE	09
1. Cilat janë kriteret e pranimi të një sinjalizimi?	09
2. Cili është roli i Shqyrtuesit të Sinjalizimeve?	10
3. Si përpunohen sinjalizimet?	10
4. Çfarë masash merren në përgjigje të sinjalizimeve?	11
III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E INDIVIDIT	12
1. Konfidencialiteti	12
2. Informimi i personave të përfshirë	12
3. Mbrojtja e sinjalizuesit	13
4. Përgjegjësitë e personave të marrë në pyetje	13
5. Arkivimi i të dhënave	13
IV. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	14



Politika e sinjalizimit është e përcaktuar në Parimet e Sjelljes dhe Veprimit, të cilat zbatohen për të gjithë punonjësit dhe drejtuesit e Saint-Gobain.

Ajo përmbush angazhimet ndërkombëtare të ndërmarra nga Grupi¹, si dhe detyrimet që burojnë nga ligjet franceze, e në veçanti ligji nga Sapin II².

I. RAPORTIMI I NJË INCIDENTI

Të gjithë **punonjësit** e Grupit (stafi me kontrata të përhershme ose me kohë të pjesshme, praktikantët, stazhierët, punëtorët e përkohshëm...) si dhe furnitorët, nënkontraktorët, klientët ose **palët e tjera të interesit** të lidhura me Saint-Gobain kanë akses në Sistemin e sinjalizimit SpeakUp! përmes faqes së internetit të Grupit³.

1/ Çfarë lloj shkeljesh mund të raportohen



Shkeljet që mund të raportohen janë veprime ose sjellje që bien ndesh me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe me Parimet e Sjelljes dhe Veprimit.

Këto shkelje mund të kryhen nga punonjësit, të trajnuarit, stafi i përkohshëm ose ofruesit e shërbimeve që punojnë për Saint-Gobain, si dhe nga nënkontraktorët në kontekstin e marrëdhënieve të tyre të biznesit me Grupin.

1. Karta e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër rryshfetit, dhjetë parimet e Paktit Global dhe Udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik ('OECD') për Ndërmarrjet Shumëkombëshe.
2. Ligji nr. 2016-1691, datë 9 dhjetor 2016, "Për transparencën, luftën kundër korrupsionit dhe modernizimin e jetës ekonomike", i ndryshuar me ligjin nr. 2022-401, datë 21 mars 2022, "Për mbrojtjen e sinjalizuesve".
3. <https://www.saint-gobain.com/en/corporate-responsibility/our-pillars/business-ethics>

Sinjalizimet klasifikohen në katër kategori kryesore shkeljesh në fushat e mëposhtme:

– **Korrupsioni, mashtrimi dhe konflikti i interesit:**

- Korrupsioni dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm
- Vjedhja, përvetësimi, pastrimi i parave dhe shkelje të tjera financiare (duke përfshirë parregullsitë në pasqyrat financiare)
- Konfliktet e interesit

– **Diskriminimi, ngacmimi seksual dhe shkeljet e të drejtave të njeriut:**

- Mosrespektimi i lirisë së organizimit
- Përdorimi i punës së detyruar ose punës së fëmijëve
- Diskriminim, cenimi në moral ose ngacmimi seksual, sjellja e dhunshme
- Mosrespektimi i legjislacionit të punës
- Shkelja e të drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale

– **Mjedisi, shëndeti dhe siguria:**

- Dëmi mjedisor
- Dëmi ndaj shëndetit dhe sigurisë

– **Shkelje të tjera:**

- Praktika anti-konkurruese
- Mosrespektimi i kontrolleve të eksportit, sanksioneve ekonomike dhe embargove
- Moskonformiteti i produkteve, sistemeve ose shërbimeve të shitura nga Grupi
- Tjetër

Kjo listë nuk është shteruese dhe këto fusha mund të zhvillohen më tej me kalimin e kohës.

2/ Si raportohet një incident?

Ata persona që dëshirojnë të raportojnë një shkelje mund të kontaktojnë eprorin e tyre, menaxherin e burimeve njerëzore, Shqyrtuesin e Sinjalizimeve⁴ ose të përdorin platformën SpeakUp! ose një linjë telefonike të dedikuar, me opsionin për të mbetur anonim në dy rastet e fundit.

Kujdes! Në rast **emergence** (siç është një kërcënim i menjëhershëm për jetën ose pronën), kontaktoni menjëherë eprorin ose shërbimet përkatëse të urgjencës.

A. Platforma online:



SpeakUp! është një platformë online e krijuar posaçërisht për të mbledhur raportime anonime dhe jo anonime. Është e disponueshme në mbi 30 gjuhë dhe mund të aksesohet këtu: <https://www.bkms-system.net/saint-gobain>.

Ky sistem është shumë i sigurt: vetëm shqyrtuesit e sinjalizimeve për shtetin ose perimetrin përkatës do të kenë akses në përmbajtje.



Kur një raportim bëhet në mënyrë anonime, autori i raportimit ka akses në një sistem mesazhesh anonim të përfshirë në platformë. Të gjitha ndërveprimet dhe shkëmbimet e informacionit zhvillohen në këtë platformë, pa akses në identitetin e autorit.

B. Linja telefonike të dedikuara:

Në disa shtete ku operon Grupi, ka linja telefonike të dedikuar në dispozicion të punonjësve dhe palëve të treta për raportim anonim ose jo anonim. Numrat e telefonit dhe kushtet e aksesit jepen të detajuara në **shtojcën 1 dhe në intranetin e Grupit**.

4. Lista e shqyrtuesve të sinjalizimeve është e disponueshme në intranet. Koordinatorët e sinjalizimeve marrin dhe trajtojnë sinjalizimet për vendin ose zonën e tyre, në përputhje me Kartën e Shqyrtuesve të Sinjalizimeve në shtojcën 3

B. Mjete të tjera:

Sinjalizuesit mund të raportojnë drejtpërdrejt me shkrim me çdo mjet, ose verbalisht. Në këtë rast, personi që merr raportimin duhet të sigurojë konfidencialitetin më të rreptë dhe të sugjerojë që sinjalizuesi të përdorë platformën **SpeakUp**!⁵



Kur personi kërkon të raportojë me videokonferencë ose takim fizik, intervista duhet të organizohet jo më vonë se njëzet ditë pune pas marrjes së kërkesës për një takim.



Pavarësisht nga kanali i zgjedhur për raportimin, një konfirmim për marrjen dijeni duhet t'i dërgohet me shkrim autorit të raportimit jo më vonë se 7 ditë pune pas marrjes së raportimit.

B. Ndërmjetësit:

Sinjalizuesit mund të kërkojnë ndihmën e çdo personi fizik ose juridik (OJQ, sindikatë ose shoqatë) për t'i ndihmuar ata të raportojnë një rast. Ky person, i njohur si “ndërmjetësues”, gëzon të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi.

3/ Çfarë informacioni jepet në raportim?


Personi që bën raportimin duhet të japë një përshkrim të saktë të fakteve, datave ose periudhave në fjalë, nëse ka njohuri personale për to, dhe për rrethanat, në mënyrë që raportimi të mund të merret në konsideratë. Ata mund të paraqesin edhe dokumente në mbështetje të raportimit.

Asnjë masë disiplinore ose hakmarrëse nuk do të ndërmerret kundër autorit të një raportimi nëse raportimi, i bërë me mirëbesim, më pas rezulton i gabuar ose i pabazuar.

Kujdes! Autori i sinjalizimit nuk duhet të zbulojë asnjë informacion që mbulohet nga sekreti i mbrojtjes kombëtare, sekreti mjekësor i një pale të tretë, sekreti i procedurave gjyqësore, sekreti i hetimit ose i hetimit gjyqësor, ose sekreti profesional i një avokati.

II. TRAJTIMI I SINJALIZIMEVE

Hapat kryesorë në trajtimin e sinjalizimit janë si më poshtë:



1/ Cilat janë kriteret e pranimit të një sinjalizimi?

Sinjalizimet pranohen për shqyrtim në rastet kur:

- veprimet kanë të bëjnë me një shkelje⁶ të politikës aktuale të sinjalizimit, dhe
- personi që bën raportimin vepron pa pritur shpërblim financiar në këmbim, dhe në mirëbesim⁷.

Kur faktet ndodhin jashtë aktiviteteve profesionale, sinjalizuesi duhet të ketë njohuri personale për to në mënyrë që të përfitojë nga mbrojtja e sinjalizuesit.

Pas marrjes së një raportimi, shqyrtuesi i sinjalizimit kryen një analizë paraprake për të përcaktuar nëse raportimi përbën një sinjalizim të pranueshëm. Nëse ai nuk është në gjendje të marrë një vendim, atëherë ai të kërkojë informacione të mëtejshme nga autori i sinjalizimit dhe të kërkojë shërbimet e profesionistëve kompetentë për të bërë këtë vlerësim.

Vetëm sinjalizimet e pranueshme mund të hetohen nga brenda, ose t'i përcillen departamentit përkatës për përpunim kur nuk kërkohet hetim i brendshëm.

6. pika I.1) çfarë lloj shkeljesh mund të raportohen?

7. Një person konsiderohet se po vepron me mirëbesim nëse ka arsye të qenësishme për të besuar se faktet e raportuara janë të vërteta në dritën e informacionit që ka në dispozicion.

>> Nëse sinjalizimi nuk pranohet për shqyrtim, autori i sinjalizimit informohet me shkrim dhe, nëse është e nevojshme, referohet te personat e duhur që mund ta ndihmojnë. Më pas, Shqyrtuesi i Sinjalizimit e mbyll sinjalizimin.

>> Nëse raportimi pranohet për shqyrtim, Shqyrtuesi informon sinjalizuesin me shkrim, brenda maksimumi 3 muajsh nga konfirmimi i marrjes së raportimit, për masat e planifikuara ose të marra për të verifikuar saktësinë e pretendimit.

2/ Cili është roli i Shqyrtuesit të Sinjalizimeve8?

Shqyrtuesit e Sinjalizimeve janë të autorizuar të komunikojnë me sinjalizuesit. Ata kanë aftësitë për të kryer detyrën e tyre për identifikimin e shkeljeve të mundshme dhe kryerjen e një hetimi të brendshëm në mënyrë konfidenciale, profesionale dhe të paanshme.

Rrjeti i Shqyrtuesve të Sinjalizimeve mund të përbëhet nga:

- Drejtorët e Etikës dhe Pajtueshmërisë në rajone, grupe, vende dhe aktivitete;
- Shqyrtuesit e posaçëm të sinjalizimeve me specializim, për shembull, në Burimet Njerëzore, EHS (Mjedisi, Shëndeti dhe Siguria), auditim, kontrollin e brendshëm.

Duke nënshkruar kartën e Shqyrtuesit të Sinjalizimeve9, çdo Shqyrtues Sinjalizimesh angazhohet për ruajtjen e konfidencialitetit, paanshmëri, transparencë dhe besnikëri.

3/ Si përpunohen sinjalizimet?

Kur niset një hetim i brendshëm, qëllimi i tij është të përcaktojë nëse faktet e zbuluara nga sinjalizimi janë të vërteta, përfundimet që duhen nxjerrë dhe ndonjë rekomandim për veprime të mëtejshme.

Sinjalizimet e pranueshme trajtohen sipas parimeve të mëposhtme:

- Shqyrtuesi i Sinjalizimit mund të krijojë një ekip hetimor (me punonjës të Grupit dhe/ose ekspertë të jashtëm), në varësi të aftësive të kërkuara, për të analizuar faktet e raportuara nga sinjalizuesi.

8. Emrat e shqyrtuesve të sinjalizimeve dhe të dhënat e kontaktit janë të disponueshme këtu: [EC List of Alert Referents](#), [EN.pdf](#).

9. referuar Shtojca 3

- Shqyrtuesi i sinjalizimeve është i autorizuar të konsultojë çdo dokument të brendshëm që ata e gjejnë të dobishëm në shqyrtimin e fakteve dhe të thërrasë çdo person që mund të hedhë dritë mbi çështjen. Ata do të përpiqen të mbledhin vetëm të dhëna që janë relevante dhe rreptësisht të nevojshme për hetimin (parimi shmangies së të dhënave të panevojshme dhe minimizimit). Ata informojnë të kontaktuarit për natyrën konfidenciale të kërkesës.
- kur Shqyrtuesi i Sinjalizimit konsideron se janë mbledhur informacione të mjaftueshme, ai duhet t'i paraqesë konkluzionet e tij strukturës drejtuese, të mbyllë çështjen dhe të informojë sinjalizuesin për mbylljen e hetimit.

Kujdes! Përveç grupit të caktuar hetimor, askush nuk ka të drejtë të informohet, të ndërhyjë në një hetim ose të mbledhë prova ose dokumente në lidhje me sinjalizimin pa pasur të drejtën për ta bërë këtë.

4/ Çfarë masash merren në përgjigje të sinjalizimeve?

Pas përfundimit të hetimit, Shqyrtuesi i Sinjalizimit përcjell gjetjet dhe rekomandimet e tij te struktura drejtuese përkatëse për ndërmarrjen e veprimeve.

Veprimet vijuese mund të përfshijnë:

- një plan veprimi (për shembull, fillimi i një auditimi, ndryshimi i një procesi, riorganizimi i një departamenti, ngritja e kurseve të trajnimit);
- sanksione disiplinore;
- procedurat civile;
- ose edhe depozitimin e një padie.

III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E INDIVIDIT

1/ Konfidencialiteti

Parimi i konfidencialitetit është gurthemeli i sistemit të sinjalizimit. Konfidencialiteti shfaqet në disa mënyra brenda sistemit:

- Shqyrtuesit e Sinjalizimeve angazhohen për ruajtjen e konfidencialitetit, duke nënshkruar Kartën e Shqyrtuesit të Sinjalizimeve;
- personat që janë intervistuar dhe konsultuar marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin më të rreptë në lidhje me sinjalizimin dhe përmbajtjen e informacioneve të shkëmbyera;
- Grupi merr përsipër të respektojë konfidencialitetin e të dhënave personale të palëve të interesuara (pra të sinjalizuesve dhe personave të përmendur ose të përfshirë në sinjalizim);
- Identiteti i sinjalizuesit dhe të dhënat identifikuese mund të zbulohen vetëm me pëlqimin e tyre dhe mund të aksesohen vetëm nga ata që janë të përfshirë në trajtimin e çështjes. Nxjerrja e paautorizuar e informacionit mund të rezultojë në masa disiplinore.

2/ Informimi i personave të përfshirë

Personat e përmendur në një sinjalizim ose hetim kanë të drejtë të dinë arsyet e tij. Në varësi të nevojave të hetimit, ata mund të informohen për ecurinë e tij.

Grupi gjithashtu merr përsipër të informojë personat e implikuar dhe të përmendur në sinjalizim, mbi rregulloret e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale, siç detajohet në Njoftimin Informues¹⁰. Në varësi të kontekstit, ky informacion mund të jepet në fillim të shqyrtimit (nëse është e mundur) ose në një datë të mëvonshme.

10. Detajet se si të ushtroni të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale jepen në Njoftimin Informues.

3/ Mbrojtja e sinjalizuesit

Asnjë masë disiplinore, procedim ligjor apo masë tjetër hakmarrëse nuk mund të ndërmerret kundër sinjalizuesit ose çdo personi që ka ndihmuar sinjalizuesin në paraqitjen e raportimit të tij ("ndërmjetësuesit"), nëse ata janë duke vepruar në mirëbesim, edhe nëse faktet e raportuara nuk janë konfirmuar në përfundimi i hetimit ose nëse raportimi mbyllet pa veprime të mëtejshme.



Mbrojtja e sinjalizuesve do të pezullohet nëse hetimi më pas zbulon se ata kanë vepruar me keqbesim.

4/ Përgjegjësitë e personave të marrë në pyetje

Në zbatim të Parimeve të Sjelljes dhe Veprimit, dhe në veçanti të Parimeve të Besnikërisë dhe Integritetit, të gjithë punonjësit e përfshirë në një hetim duhet të bashkëpunojnë (p.sh. të ofrojnë dokumentet e kërkuara, të mos shkatërrojnë dokumentet ose të bashkëpunojnë me një dëshmitar) dhe t'u përgjigjen pyetjeve me ndershmëri.

5/ Arkivimi i të Dhënave

Mbrojtja e individëve dhe të dhënave të tyre personale është thelbësore për angazhimet e Shqyrtuesve të Sinjalizimeve. Procesi i menaxhimit të sinjalizimeve i përshkruar në këtë Politikë për Sinjalizimet dhe në sistemin e dedikuar të informacionit SpeakUp!, janë krijuar për të siguruar që të dhënat të mos përdoren për ndonjë qëllim tjetër përveç trajtimit të sinjalizimeve dhe të mbahen të sigurt vetëm për kohën e nevojshme për përpunimin, dhe asnjë moment më shumë. Vetëm informacioni rreptësisht i nevojshëm për trajtimin e sinjalizimeve mbledhet dhe përpunohet.

Sinjalizimi	Arkivimi i të dhënave
Sinjalizim i papranueshëm	Anonimizohen në tremujorin pas analizës së pranueshmërisë.
Sinjalizim i pranueshëm - në proces përpunimi	Mbahen në bazë aktive deri në vendimin përfundimtar për veprim të mëtejshëm.
Sinjalizim i pranueshëm, i përpunuar dhe mbyllur pa veprime të mëtejshme	Anonimizohen në tremujorin pas vendimit përfundimtar për ndjekjen.
Sinjalizim i pranueshëm, i përpunuar dhe i mbyllur, duke çuar në veprime të mëtejshme	Ruhen të dhënat deri në përfundimin e procedurës ose përfundimin e afatit kohor të ankimit kundër vendimit.

Të dhënat personale të përpunuara në kontekstin e sinjalizimeve i nënshtrohen një politike arkivimi të detajuar në [Njoftimin Informues](#).

IV. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë sinjalizimi dhe përditësimet e saj janë përgjegjësi e departamentit të Etikës dhe Pajtuashmërisë.

Roli i Drejtorëve të Etikës dhe Pajtuashmërisë në secilin Rajon, Vend ose Klaster ose aktivitet është që:

- aty ku është e nevojshme, të përshtatin politikën për të marrë parasysh specifikat lokale, pa cenuar megjithatë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe personave të përmendur në sinjalizim, dhe ta përkthejnë atë në gjuhët e zgjedhura.
- të sigurojnë që kjo Politikë për Sinjalizuesit të shpërndahet tek të gjitha subjektet brenda fushës së tyre.
- të sigurojnë që një "Paketë Komunikimi" të vihet në dispozicion të Burimeve Njerëzore dhe Drejtuesve.
- të këshillojnë këdo që ka pyetje në lidhje me Politikën e Sinjalizimit.

Drejtuesit janë përgjegjës për të siguruar që punonjësit e ekipeve të tyre janë të vetëdijshëm për këtë Politikë Sinjalizimi.

14 ⁶ I nënshtrohet, aty ku është e zbatueshme, një urdhri gjykatë (ose kërkesë tjetër ligjore) që detyron Grupin të japë informacionin.

Shtojcë

SHTOJCA 1 : Linjat telefonike

Shteti	Numri i telefonit	Gjuhët	Lloji i shërbimit
Angola	+244226425575	Portugalisht dhe anglisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Botsvana	00-267-800-786-1099	Anglisht dhe Setswana	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Bregu i Fildishtë	+2252721340766	Frëngjisht dhe anglisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Gana	+233596992705	Anglisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Kenia	+254203894200	Anglisht dhe suahilisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Mauritus	+23052970985	Frëngjisht dhe anglisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Evropa	+33187212291	Anglisht, frëngjisht, gjermanisht, polonisht dhe spanjisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
SHBA	+12132791015	Anglisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht dhe rusisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
Kanada	+12894019198	Anglisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht dhe rusisht	SpeakUp! postë zanore Kodi 4558
MB	0844 847 6649	Anglisht	Mbledhja e sinjalizimeve nga personeli i autorizuar
Meksikë	+5255 54150773	Spanjisht	Postë zanore
Kolumbi	+5255 54150773	Spanjisht	Postë zanore
Ekuador	+5255 54150773	Spanjisht	Postë zanore
Brazil	0800 792 1018	Portugalisht	Postë zanore

SHTOJCA 2 : Procedura për mos marrjen hak

Gjatë hetimit dhe pas mbylljes së tij, një sinjalizues, ndërmjetësues ose çdo person tjetër i përfshirë në hetim që ndjen ose ka frikë nga hakmarria mund të raportojë situatën nëpërmjet sistemit të sinjalizimit ose drejtpërdrejt duke informuar Shqyrtuesin e Sinjalizimit.

Aty ku konfirmohet rreziku i hakmarjes, masat mbrojtëse specifike

mund të propozohen nga Shqyrtuesi i Sinjalizimit, në bashkëpunim me departamentin përkatës të burimeve njerëzore, për shembull:

- transferimi i përkohshëm ose i përhershëm (p.sh. puna nga shtëpia);
- një ndryshim në hierarkinë drejtuese;
- angazhimi me BNJ për të monitoruar situatën në vendin e punës.

Punonjësit që kryejnë ose kanë kryer hakmarrje mund t'u nënshtrohen masave disiplinore, deri në dhe duke përfshirë largimin nga puna.

SHTOJCA 3 : Karta e Shqyrtuesit të Sinjalizimeve

Saint-Gobain ka ngritur një sistem sinjalizimi etik dhe profesional të hapur për të gjithë punonjësit dhe palët e interesuara (klientët, furnitorët, aksionarët, sindikatat, OJQ-të, autoritetet lokale, shteti, etj.).

Efektiviteti i këtij sistemi mbështetet në rrjetin e Shqyrtuesve të Sinjalizimeve, të cilët janë përgjegjës për trajtimin e duhur të sinjalizimeve. Pra, Shqyrtuesi i Sinjalizimeve është përgjegjës për:

- mbledhjen dhe regjistrimin e sinjalizimeve në sistemin e dedikuar;
- gjetjen e fakteve, analizën e të dhënave dhe intervistimin;
- komunikimin me personat e prekur nga sinjalizimi;
- nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për veprim;
- dokumentimin e të gjithë procesit vijues në [SpeakUp!](#)

Si pjesë e misionit të tij, Shqyrtuesi i Sinjalizimeve duhet të jetë në përputhje me Parimet e Sjelljes dhe Veprimit dhe në këtë mënyrë merr përsipër të respektojë detyrimet shtesë të

mëposhtme:

- të sigurojë që janë marrë masa për të mbrojtur njerëzit dhe Grupin.
- të respektojë parimet e konfidencialitetit, mprehtësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit, proporcionalitetit dhe kufizimit vetëm në ato të dhëna që janë të domosdoshme për t'u mbledhur, si dhe transparencës dhe drejtësisë ndaj personave, të dhënat e të cilëve përpunohen.
- të mbajë rreptësisht konfidencial identitetin e sinjalizuesit.
- të nxjerrë informacionin vetëm te personat e prekur (të cilët supozohet se nuk kanë faj deri në përfundimin e hetimit) dhe të japë informacione rreth sinjalizimit vetëm te ata persona që duhet të dinë atë.
- të mos jetë në një situatë konflikti interesi ose në rrezik për të qenë në një situatë të tillë; nëse ka konflikt interesi, ata duhet të tërhiqen menjëherë nga trajtimi i sinjalizimit dhe të informojnë Departamentin e Etikës dhe Pajtueshmërisë.

Shqyrtuesi i Sinjalizimit është përgjegjës për sigurimin e pajtueshmërisë me këto parime nga çdo person (i brendshëm ose i jashtëm i Grupit) të cilit ata i delegojnë të gjitha ose një pjesë të detyrave të Shqyrtuesit të Sinjalizimit, ose të cilit i kërkojnë ndihmë; ata sigurojnë që ky person nuk është, ose nuk ka gjasa të jetë, në një situatë konflikti interesi. Ky person duhet të nënshkruajë edhe këtë Kartë.

Këto detyrime janë një parakusht për funksionimin e duhur të sistemit të sinjalizimit të Grupit. Çdo shkelje mund të shkaktojë procedime disiplinore ose ligjore.

SHTOJCA 4 - France : autoritetet përgjegjëse për marrjen e raportimeve

Lista e autoriteteve kompetente për marrjen e sinjalizimeve është e detajuar në shtojcën e Dekretit nr. 2022-1284, datë 3 tetor 2022, për procedurat e marrjes dhe përpunimit të sinjalizimeve të lëshuara nga sinjalizuesit dhe përcaktimin e listës së autoriteteve të jashtme të krijuar me Ligjin nr. 2022-401, datë 21 mars 2022, me synimin përmirësimin e mbrojtjes së sinjalizuesve, të disponueshme në linkun e mëposhtëm:

https://www.legifrance.gouv.fr/loda/article_lc/LEGIARTI000046357809/2023-01-06



ETIKA DHE PAJTUESHMËRIA
NGA SAINT-GOBAIN